



Nje penallti ne minuten e 14 ka acaruar lojtaret e Vllaznise. Gjyqtari ka akorduar nje 11 metersh teper te dyshimte. Akuzat e kuqeblove kane qene te menjehershme per faullin qe gjyqtari ka pare. Sulmuesi i Flamurtarit ka qene gati dy metra jashte zones por kryesori e ka pare ate si faull brenda zones. Akuzat e Vllaznise per kete 11 metersh “fantazem” kane qene mjaft te medha. Kuqeblove pritet te denoncojne ne FSHF gjyqtarin kryesor Enea Jorgji dhe ndihmesit e tij qe kane bere edhe shume gabime te tjera.